



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

SENATI

Nr. 324/3 Prot.

Tiranë, më 27.02.2018

VENDIM

Nr. 9 datë 27.02.2018

MBI

**MIRATIMIN E TESTEVE PRAKTIKE TË KONKURSIT PËR PRANIMIN E  
STUDENTËVE ME KOHË TË PLOTË TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË UST  
DHE NJË SHITESË NË RREGULLORET E KONKURIMIT**

Mbështetur në nenit 74/2, të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 14 pika 6/z të Rregullores së UST-së, në Vendimin e Rektoratit nr.27dt. 20.02.2018, Senati në mbledhjen e dt. 27.02.2018

**V E N D O S I:**

1. Testet Praktike të Konkursit për Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes (FSHL) dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit (FVFR), të miratuara me Vendimin e Senatit UST nr. 18, dt. 3. 04. 2017 mbeten në fuqi. Këto teste do përdoren në organizimin e konkurimit të kandidatëve për pranimet në programet e studimit në ciklin e parë bachelor.
2. Miraton një shtesë në Rregulloren "Për zhvillimin e konkursit të pranimit, Universiteti i Sporteve Tiranë, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, viti akademik 2017-2018" e FSHL. Shtohet pika 23 me këtë përmbajtje: "Kandidati konkurues, minimalisht, duhet të marrë së paku 10 pikë në testin e konkursit praktik. Nëse merr më pak se 10 pikë, kandidati nuk shpallet fitues dhe nuk regjistrohet për të ndjekur studimet."
3. Miraton një shtesë në Rregulloren "Për zhvillimin e konkursit të pranimit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit për vitin 2017-2018" e FVFR. Shtohet pika 3.17 me këtë përmbajtje: "Kandidati konkurues, minimalisht, duhet të marrë së paku 10 pikë në testin e konkursit praktik. Nëse merr më pak se 10 pikë, kandidati nuk shpallet fitues dhe nuk regjistrohet për të ndjekur studimet."
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Rektorati, Dekanët e Fakulteteve, Dega e Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

Prof. Dr. Agron **CUKA**

